REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
QENDRA SIZMOLOGJIKE

Eduard Sulstarova
Siasi Kociaj

KATALOGU I TERMETEVE TE SHQIPERISE

Tirane 1975

Shtypur ne Shtypshkronjen Revista - Dispenca
Tirazhi 300

PARATHENIE

Shqiperia eshte nje vend me aktivitet te theksuar sizmik. Duke e njohur kete realitet, Partia dhe Qeveria e jone qe ne vitet e para te çlirimit vune detyra per studimin e termeteve dhe marrjen e masave antisizmike per mbrojtjen e ekonomise sone nga dem[illegible]et njerezore dhe materiale. Per kete qellim jane hartuar dhe jane ne fuqi rregullore te posaçme mbi ndertimet antisizmike, si dhe nje harte sizmike-harta e vitit 1952 (me disa koregjime te bera ne vitin 1963). Shteti investon çdo vit shuma te medha per sigurimin e objekteve nga veprimi shkatrrues i termeteve.

Per organizimin e studimeve te thelluara mbi sizmicitetin e Shqiperise, ne te gjitha aspektet e tij, u ngrit gjashte vjet me pare Stacioni sizmologjik i Tiranes, sot Qendra Sizmologjike prane Akademise se Shkencave te RPSH, detyra imediate e se ciles eshte kryerja e studimeve per rajonizimin sizmologjik te Shqiperise ne shkalle 1. 500.000.

Vepra qe po paraqesim eshte kryer ne kuadrin e temes shkencore "Rajonizimi sizmologjik i Shqiperise ne shkalle 1:500.000» dhe perben ne kete kuader studimin me te rendesishem. Ajo do te jete mbeshtetje per kryerjen e mjaft studimeve te tjera sizmologjike qe jane planifikuar te kryhen ne te ardhmen.

Qe ne vitin 1963, me daljen e vendimit te Keshillit te Ministrave per ngritjen e sherbimit sizmologjik shqipetar, filloi ne Fakultetin Gjeologji-Miniera, puna per mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave mbi termetet e Shqiperise, e cila u zgjerua me ngritjen e Stacionit sizmologjik. Rrjedhimisht vepra qe po paraqesim eshte rezultat i nje pune shume vjeçare qe kane kryer autoret per mbledhjen dhe perpunimin e materialit.

Si fillese, e ketij studimi, eshte perpilimi i bibliografise se termeteve shqiptare, e cila mbasi u sigurua, u shfrytezua plotesisht (shih referencat e katallogut). U shfrytezua i gjithe shtypi i kohes, qe ndodhet ne bibliotekat tona, Arkiva e Shtetit (per materialet e sistemuara), arkivat e rretheve etj. Per mbledhjen dhe verifikimin e materialit makrosizmik u kryen mjaft ekspedita fushore ne gjithe territorin e Republikes.

Ne vitin 1971 ne manografine « Harta e rajonizimit sizmologjik te RPSH, shkalla 1:2.500.000» u paraqit dhe nje katallog i termeteve shqipetare per

periudhen 1800 -1970 me Io ≥ VII balle (gjithesej 280 termete). Ne vitin 1972, ne monografine « Harta sizmike e RPSH ne shkalle 1: 1.250. 000" u paraqit katallogu i termeteve po per periudhen 1800 -1970, por me Io ≥ VI (gjithesej 534 termete) si dhe 26 harta izosejtesh.

Ne vitin 1972 u shfrytezua arkiva e Observatorit sizmologjik te Shkupit (Jugosllavi), ku u gjenden mjaft materiale te rregjistrimeve instrumentale te stacioneve sizmologjike Jugosllave, per periudhen 1924-1970 si dhe materiale makrosizmike per ndjeshmerine e termeteve tane ose kufitare ne teritorin jugosllav. Ne vitin 1973 nn u dha mundesia e shfrytezimit te arkives se Byrose Qendrore Nderkombetare te Sizmologjise ne Strasburg (France), ku u gjend nje material i bollshem i rregjistrimeve instrumentale te shume stacioneve te Evropes dhe te Ballkanit per periudhen 1900 -1970, si dhe materiale mbi ndjeshmerine makrosizmike te termeteve tane ne territoret e shteteve fqinj.

I gjithe materiali instrumental i mbledhur u perpunua sipas metodikave me te reja. Per kete qellim u hartua nje program per llogaritjen me maqine llogaritese dhe u llogariten parametrat kryesore mikrosizmike te gjithe termeteve tane per periudhen 1900 -1965 (koordinatat e epiqendres, φ, λ, magnituda M, thellesia e vatres h, koha ne origjine H).

Ne baze te materialit makrosizmik te mbledhur dhe te perpunuar (bazuar ne shkallen MSK -1964) u perpiluan 60 harta izosejstesh, u homogjenizua i gjithe materiali makrosizmik. Mandej u zgjodh modeli i fushes makrosizmike dhe ne baze te tij u hartua nje program per llogaritjen ne makine llogaritese te parametrave kryesore makrosizmike (thellesia e vatres, intensiteti ne epiqender, intensiteti i korrigjuar, rrezet e mezatarizuara te ndjeshmerise se termeteve). Ne baze te te dhenave makrosizmike u percaktuan dhe koordinatat e epiqendrave.

Gjate perpunimit, perveç llogaritjeve te parametrave te vatres se termeteve, u percaktuan dhe gabimet e mundeshme ne llogaritjen e tyre si dhe u gjenden raportet qe ekzistojne ndermjet parametrave kryesore te termetëve tane.

Me rendesi paraqitej dhe zgjedhja e kufirit te poshtem te intensitetit te termetëve, mbi te cilin materiali i paraqitur ne katallog duhet te jete homogjen ne hapesire dhe ne kohe. Duke u nisur nga arsyet e treguara ne &1, per periudhen 1900 -1970, si kufi i poshtem u muar M ≥ 4 ose I° ≥ VI per periudhen 1800-1900 Io ≥ VII balle, ndersa per periudhen para vitit 1800, Io ≥ VIII balle.

Nese per periudhen 1900-1970 materiali paraqitet i plote dhe me homogjen ne hapsire dhe ne kohe, i perpunuar plotesisht, per periudhen para vitit 1900 dhe sidomos para vitit 1800, ka nevoje per mbledhje materialesh te reja uga burime qe ende nuk jane shfrytezuar.

Ne vepren « katalogu i termeteve shqiptare», qe po paraqesim, nuk jepet nje renditje e thjeshte kronollogjike e fakteve te mbledhura, por nje interpretim i shumanshem i parametrave fizike te termeteve tane. Megjithate, nje katallog termetesh perfaqeson nje veper per te cilen nuk mund te thuhet ne menyre te prere

se eshte pune e mbaruar, ai ka nevoje per plotesime dhe saktesime te metejshme, sidomos per periudhen para vitit 1900. Megjithate materiali i paraqitur arrin nje shkalle te tille homogjeniteti ne hapesire dhe ne kohe qe ben ate te dobishem per disa qellime.

Vepra ndahet ne tre pjese:

Pjesa e I-re: perben katallogun e termeteve me M ≥ 4 ose Io ≥ VI per periudhen 1900-1970 (gjithesej -557 termete)

Pjesa e II-te: perben katalogu e termeteve me Io ≥ VII per periudhen 1800-1900 dhe Io ≥ VIII per periudhen para vitit 1800 (Gjithesej 98 termete).

Pjesa e III-te: permban pershkrimet e 58 termeteve si dhe hartat e izosejsteve per 60 termete.

Vepra ka dhe 2 shtojca: shtojca e pare ka katalogun e gjithe goditjeve me M <4 ose Io <VI per periudhen 1900 -1970, duke inkluduar dhe pas goditjet e termeteve tefuqishem (gjithesej 1461 goditje); ndersa shtojca e dyte permban shkallen MSK -1964.

Gjithesej ne katallog jepen 2116 termete.

Antoret e ndjejnë per detyre te falenderojne ne menyre te veçante Shyqyri Aliaj, bashkepunetor shkencor i Qendres sizmologjike, per ndihmen shume te madhe qe na ka dhene ne drejtim te mbledhjes se materialit, mikro dhe makrosizmik. Falenderojme Nazmi Hiden, Agim Eminin dhe gjithe koleget e tjere te Qendres sone per ndihmen e madhe ne drejtim te sistemimit te materialit te mbledhur.

Falenderojme gjithashtu punonjesit e Qendres se matematikes llogaritese Ylli Vejsiu dhe Gudar Beqiraj, per ndihmen e madhe ne drejtim te llogaritjes se materialit ne makinen llogaritese.

Do t'u jemi mirenjohes lexuesve qe do te na ndihmoje me vrejtjet dhe keshillat e tyre.

Metodika e perpilimit te katallogut:

Nje ader detyrat kryesore te studimeve sizmologjike eshte zbulimi i ligjeve me te pergjitheshme te renies se termeteve me qellim qe te mund te merren masat perkatese mbrojtese kunder tyre, pa folur per rendesine qe kane ato per studimin e brendesise se Tokes.

Te dhenat per termetet qe kane ndodhur dhe jane vrojtuar nga e kaluara e deri me sot, ne territorin qe eshte marre ne studim jane me shume rendesi per studimin e shperndarjes ne kohe dhe ne hapesire te rrezikut te ardhshem sizmik. Keto te dhena duhet te jene sa me te shumta, perfaqesuese dhe homogjene.

Vrojtimet instrumentale dhe makrosizmike te kryera deri me sot lene shume per te deshiruar persa i perket karakterit perfaqesues te tyre. Prandaj problemi i perpilimit te katallogut te termeteve eshte problemi i homogjenizimit te te dhenave, i gjetjes se parametrave te termeteve dhe i llogaritjes se saktesise se percaktimit te ketyre parametrave.

Çdo termet mund te konsiderohet si nje pike e veçante me pese perma sa (gjeresi gjeografike φ_e, gjatesi gjeografike λ_e, thellesi vatre h, energji te shprehur ne shkallen e magnitudes M dhe kohe ndodhjeje ose lindjeje H). Per perpilimin e katallogut eshte e domosdoshme te llogariten per çdo rast vlerat me probabel te ketyre pese parametrave. Persa i perket intensitetit ne epiqender, te shprehur ne balle, ai nuk eshte nje parameter i pavarur. Teorikisht ai mund te gjendej duke njohur magnituden dhe thellesine e vatres se termetit; praktikisht ai percaktohet nga vrojtimet e kryera ne terren.

Ndryshe nga katalloget qe kane paraqitur per Shqiperine autore te tjere, si dhe nga ata qe kemi paraqitur me pare ne studime te ndryshme, (6,7), ne kete punim eshte here perpjekje per te llogaritur vlerat me te mundeshme reale te secilit parameter, duke perdorur per kete qellim te gjitha te dhenat e burimeve fillestare dhe duke i perpunuar ato ne nje rruge te vetme. Prandaj katallogu nuk paraqet nje renditje te thjeshte kronologjike te fakteve te mbledhura, por nje interpretim te shumanshem te parametrave fizike te termeteve shqiptare dhe atyre rreth vendit tone.

Per studimin e rrezikut sizmik, te dhenat mbi shperndarjen e intensitetit ne siperfaqe te tokes, kane te ujejten rendesi si dhe te dhenat per parametrat kryesore te vatres se termetit.

- Prandaj zgjedhja e modelit te fushes makrosizmike perben nje nder pikat me kyçe per perpilimin e katallogut. Ky modci mund te paraqitet ne formen e pergjitheshme:

$$I_i = F(M, h, \varphi_e, \lambda_e, \varphi_i, \lambda_i,) \qquad (1)$$

ku

I_i eshte intensiteti ne nje pike te çfaredoshme me koordinata φ_i dhe λ_i

ndersa M, h, φ_e, λ_e paraqesin parametrat e vete termetit te shpjeguar me siper.

Varesia e siperme mund te perdoret per zgjidhjen e problemit te drejte dhe te zhdrejte, dmth. mund te llogaritet intensiteti ne çdo pike sipas parametrave te vatres dhe anasjelltas, mund te llogariten parametrat e vatres ne varesi te intensitetit te vrojtuar.

Duke u bazuar ne idene e mesiperme procesi i perpilimit te katallogut ka kaluar keto etapa:

1. Mbledhja e te dhenave nga te gjithe burimet e mundeshme
2. Krahasimi dhe kontrolli i te dhenave kontradiktore, duke kerkuar ne keto raste burime plotesuese
3. Zgjedhja e rasteve me informacion me te mire, zgjedhja e modelit te tipit (1) dhe percaktimi i parametrave numerike te ekuacionit (1)
4. Llogaritja e parametrave qe mungojne dhe gabimeve te mundeshme te te gjithe parametrave duke u bazuar ne modelin dhe parametrat numerike te ekuacionit (1).
5. Paraqitja e katallogut ne formen perfundimtare

&. 1. *Informacioni sizmologjik*

a. Burimet.

Per perpilimin e ketij studimi jane shfrytezuar burime tendryshme (shih referencat e katalogut); autoret e studimit kane mbledhur njekohesisht nje material tjeter te madh doknmentaro-historik, nga shtypi i kohes dhe kronikat lokale, gjate ekspeditave tendryshme te kryera per termetet e rinj dhe te vjeter.*

Per periudhen 1900 -1970 jane mbledhur gjithashtu te dhenat e rregjistrimeve instrumentale te kryera nga stacionet evropiane si dhe buletinet e agjensive nderkombetare te ISS (1913 -1963), ISC (1964-1970), BCIS (1951-1970) dhe IPG, Strasbourg (1919 -1962).

b. Shperndarja ne hapsire

Per studimin e sizmicitetit te Shqiperise ne pergjithesi dhe per perpilimin e katallogut ne veçanti, jane mbledhur dhe perpunuar te dhena qe i perkasin territorit te perfshire midis paraleleve 39°20' dhe 43°, dhe meridianeve 19°dhe 21°; (Ne nje sektor te ngushte ne afersi te liqenit te Ohrit dhe te Prespes deri 21°30'). Keshtu qe ne sektorin qe merret ne studim perfshihet jo vetem territori i RPSH, por edhe nje zone jashte kufijve, me qellim qe te kihet parasysh edhe influenca e termeteve kufitare ne truallin tone shteteror si dhe lidhjet qe ekzistojne midis sizmiciteti dhe tektonikes per zona te ndryshme sizmogjene, te cilat shtrihen edhe jashte kufijve tane.

c) Shperndarja ne kohe

Qe nga viti 1900, ne territorin e Evropes dhe te vendeve fqinje, ka vepruar nje rrjet stacionesh sizmologjike, te cilat kane rregjistruar, nje numer te madh te termeteve tane te forte; nga ana tjeter qe nga fillimi i ketij shekulli ne shume vende te Ballkanit dhe Evropes kane i funksionuar sherbimet sizmologjike, te cilat jane marre me studimin dhe mbledhjen e te dhenave per termetet. Nje kontribut te çmuar kane dhene dhe japin ne kete drejtim dhe qendrat nderkombetare ISS (sot ISC) dhe BCIS.

Rrjeti i stacioneve sizmologjike ka ardhur duke u zgjeruar, aparatura sizmologjike e kane rritur vazhdimisht ndjeshmerine etyre, rrjedhimisht eshte shtuar shume numuri i ngjarjeve sizmike te rregjistruara.

Deri ne vitin 1950 instrumentat evropiane me zmadhim 200-2000 kane mundur te dedektojne termetet me magnitude 2.5 ne distanca deri 100 km. larg stacionit. Ndersa ne distanca deri 400 km. larg, ata kane mundur te dedektojne termetet me magnitude 3.5 (ne kete largesi ndodheshin prej nesh stacionet greke, jugosllave dhe italiane).

Me poshtë jepet tabela e dedektimit te termeteve me magnitude 2.5 -5.0 nga stacionet evropiane ne varesi te largesise se stacionit prej epiqendres si dhe ndjeshmerise se aparatures per periudha te ndryshme kohe (2):

Magnitudat; Largesia ne grade	2.5	3.0	3.5	4.0	4.5	5.0
deri 1950 Instrumenta me zmadhim 200-2000	1°	2°	4°	8°	16°	35°
1950 -1962	1°	2.5°	8°	35°	85°	120°
1962 -1970	-	-	10°	90°	110°	140°

Nga viti 1968 ka filluar te funksionoje dhe stacioni sizmologjik i Tiranes.

Ne varesi te tabeles se mesiperme, supozohet se per periudhen 1900-1970, eshte siguruar nje rregjistrim i plote i ngjarjeve sizmike me magnitude me te madhe se 4.0 ose intensitet me te madh se VI.

Dmth. per kete periudhe ngjarjet e rregjistruara jane perfaqesuese per kete diapazon. Dihet se per nje thellesi normale te vatres (deri 33 km) intensiteti maksimal nuk i arrin VI balle sipas shkalles MKS, kur magnituda e termetit eshte me e vogel se 4.0. Meqenese termetet tane jane kryesisht termete normale, ndryshe si kufi i poshtem i termeteve perfaqesues u morren termetet me magnitude me te madhe 4.0 ose intensitet me te madh se VI balle.

Per periudhat me te vona, sidomos pas vitit 1962 me dendesimin e e rrjetit dhe rritjen e ndjeshmerise se aparaturave, eshte bere e mundur te rregjistrohen nga disa stacione edhe termete me manjituda me te vogla se 4.0; prandaj ne shtojcen e katallogut paraqiten te gjitha lekundjet e njohura me M me te vogel se 4.0 ose intensitet me te vogel se VI balle, duke perfshire ketu edhe pasgoditjet e termeteve te medhenj.

Gjate periudhes se luftes se pare dhe te dyte boterore, kemi nje ndërprerje te perkoheshme te aktivitetit te stacioneve sizmologjike dhe te shkembimit nderkombetare te te dhenave, keshtu qe per periudhat 1914 -1918 dhe 1941-45, mund te themi se ngjarjet e regjistruara nuk jane te plota.

Pra, homogjeniteti ne kohe per ngjarjet me $M \geq 4.0$ ose $Io \geq VI$ sigurohet per gjithe periudhen 1900-1970 me perjashtim te kohes se ketyre dy luftrave boterore.

Para vitit 1900, per mungese te rregjistrimeve instrumentale te dhenat per termetet, kane vetem karakter makrosizmik. Meqenese edhe sherbimet sizmologjike, nuk kane ekzistuar, te dhenat per termetet para vitit 1900 kane karakter sporadik. Megjithate, duke shfryteznar burime te ndryshme (kronika, dokumenta

* *Materiali baze ndodhet prane arkives se Qendres Sizmologjike te ASH te RPSH*

historike etj) eshte bere e mundur,te mblidhet nje fare informacioni edhe per termetet para vitit 1900 dhe per disa prej tyre te ndertohen edhe harta izoseistesh.

Lidhur me sa thame katallogu i termeteve ndahet ne tre pjese dhe nje shtojce (per termetet me M < 4.0 ose Io < VI).

Pjesa e pare:

Perfaqeson katallogun e termeteve shqiptare me M ⩾ 4.0 dhe Io ⩾ VI per periudhen 1900-1970. Kjo pjese eshte e plote dhe e perpunuar plotesisht dhe ne kete drejtim as qe mund te krahasohet me pjesen e dyte.

Pjesa e dyte: Perfaqeson katallogun e termeteve me Io ⩾ VII per periudhen 1800-1900 dhe me Io ⩾ VIII, per periudhen deri ne vitin 1800. Eshte e nevojshme te theksojme se per kete periudhe megjithe veshtiresite qe ekzistojne duhet te shfrytezohen burime arkivale te vjetra per te gjetur informacion te ri per termetet e kesaj periudhe. Nje burim i rendesishem per kete qellim do te jene arkivat e perandorive Otomane, Bizantine dhe Romake, te cilat deri me sot nuk jane shfrytezuar per qellime sizmologjike. Per kryerjen e kesaj detyre te veshtire kerkohet nje bashkpunim i gjute dhe i ngushte midis historianeve, sizmologeve, linguisteve, inxhinjereve, gjeologeve etj.

Prandaj puna e filluar dhe e paraqitur ne kete pjese duhet te vazhdoje.

Edhe ne pjesen e dyte te katallogut, te dhenat e paraqitura, jane perpunuar duke marre parasysh pershkrimet e gjetura ne burime te ndryshme.

Prandaj materiali i paraqitur per diapazonin e treguar mund te konsiderohet homogjen per periudhen 1800 -1900, ndersa persa i perket periudhes para vitit 1800 duhet theksuar mungesa e informacionit rrjedhimisht dhe ngjarjet e paraqitura nuk jane as perfaqesuese as homogjene.

Pjesa e trete: Me qellim qe te krijohet nje ide sa me e plote mbi intensitetin dhe pasojat qe kane shkaktuar termetet taue ne kete pjese jepen pershkrimet te disa termeteve te fuqishem si dhe kartat e izoseisteve per 60 termete, te paraqitura ne shkallen 1:500 000.

§ 2. *TRAJTIMI I INFORMACIONIT SIZMOLOGJIK*

a) Parimet e analizes dhe sintezes se te dhenave:

Te dhenat e mbledhura per perpilimin e katallogut nuk jane homogjene dhe ne shumicen e rasteve informacioni makrosizmik dhe instrumental nuk kane perputhje te mire me njeri tjetrin, sidomos per periudhen para vitit 1965. Prandaj parimi i pergjithshem qe u perdor per perpilimin e katallogut te termeteve, ne formen perfundimtare, ishte konfrontimi i te gjitha te dhenave ekzistuese dhe percaktimi i parametrave perfundimtare me optimale, sipas korelacioneve te gjetura ndermjet te dhenave makrosizmike dhe instrumentale.

Dihet se karakteristikat kryesore te vatres se termetit jane:

- koordinatat gjeografike φ_e, λ_e thellesia e vatres ose siperfaqja e tokes h.

- energjia e termetit qe rrezatohet nga vatra e shprehur ne permjet magnitudes M; Koha ne prigjine, ose e lindjes H.

Pergjithesisht, vatra e termetit konsiderohet si nje pike, megjithese ne realitet kjo nuk eshte keshtu, ndersa efekti i vrojtuar ne siperfaqe te tokes karakterizohet prej intensitetit sizmik I_i. Largesia midis epiqendres (φ_e, λ_e) (projeksionit te vatres ne siperfaqe) dhe pikes se vrojtimit (φ_i, λ_i) dmth. largesia epicentrale shenohet me Di, ndersa largesia hipocentrale shenohet me r_i, ku:

$$r_i = \sqrt{D\,i^2 + b^2} \qquad (2)$$

Ne rastin me te thjeshte eshte supozuar se intensiteti I_i ne nje pike te çfaredoshme, r_i varet nga magnituda M e termetit dhe largesia hipocentrale, keshtu qe ate mund ta paraqesim ne formen:

$$I_i = b\,M + f(r_i) \qquad (3)$$

ku funksioni $f(r_i)$ nuk varet nga gradienti vertikal ose horizontal i shpejtesise se perhapjes se valeve sizmike. Ekuacioni (3) shpreh te ashtuquajturen fushe makrosizmike me te cilen nenkuptohet ajo pjese e siperfaqes se tokes rreth epiqendres, ku efektet makrosizmike ekzistojne ose mund te vrojtohen. Ne te gjitha rastet kur ne njohim intensitetin ne nje pike te siperfaqes, pozicionin e epiqendres dhe magnituden, mund te perdorim varesine (3) per te kontrolluar nese parametrat M, I_i, r_i perputhen. Ne seleketa parametra kenaqia ligjeshmerite e gjetura, ata futen ne katallog. ne rasi te kundert duhet supozuar se mund te jete bere gabim ne percaktimin e njerit ose te me shume/prej tyre dhe ky gabim duhet te eliminohet duke i kaluar te gjitha te dhenat ekzistuese edhe ne njehere ne kontroll.

Ne kete rruge konfrontohen te gjitha te dhenat makrosizmike dhe instrumentale.

Zgjedhja e modelit

Si model per studimin e fushes makrosizmike u mor modeli i propozuar nga Blake (1,2, 4).

Sipas tij, shuarja e energjise prej largesise hipocentrale mund te shkruhet ne formen:

$$E_i = E_o \cdot r_i^{-n} \qquad (4)$$

ose

$$\log E_i = \log E_o - n \log r_i$$

Ne qoftese intensiteti ne nje pike te çfaredoshme do te paraqitet ne formen e varesise lineare:

$$I_i = p \log E_i + q \qquad (5)$$

ku p dhe q jane dy konstante, edhe intensiteti ne epiqender do te paraqitet po ne

formen e kesaj varesie, vecse ne kete rast eshte e qarte se ne vend te largesise r_i do te kemi vetem thellesine e vatres h, sepse $D_i = 0$

$$Io = p \log Eo - p n \log. b + q$$

ndersa

$$Ii = p \log Eo - p n \log r_i + q$$

dhe

$$Io - I_i = p n \log r_i - p n \log b \qquad (6)$$

po te shenojme $pn = 2s$ do te kemi:

$$Io - I_i = 2s \log \frac{r_i}{b} = 2s \log \frac{\sqrt{D_i^2 + b^2}}{b}$$

$$Io - I_i = 2s \log \sqrt{1 + \frac{D_i^2}{b^2}} \qquad (7)$$

Siç shihet madhesia s ne kete rast do te percaktoje ligjeshmerine e renie se intensitetit prej largesise, mbasi ne te hyn madhesia n qe perfaqeson eksponentin e vete largesise ku vrojtohet intensiteti I_i.

Per gjetjen e s perdoren metodika te ndryshme. Ne ndoqem metoden e perdorur nga Fu Cen I dhe Liu C.J. (4)

Nga formula (7) mund te shkruajme:

$$h = \frac{D_i}{\sqrt{C_i - 1}} \qquad (8)$$

ku

$$C_i = 10^{\frac{I_o - I_i}{s}} \qquad (9)$$

Per gjetjen e thellesise dhe koeficientit s, sipas formules (8) n perdor metoda e kateroreve me te vegjel. D.m.th. ne rastin tone duhet te plotesohen konditat:

$$F = \sum_{1}^{n} \left(b - \frac{D_i}{\sqrt{C_i - 1}} \right)^2 = min$$

ose

$$\frac{\partial F}{\partial b} = 0 \quad dhe \quad \frac{\partial F}{\partial s} = 0$$

je qe eshte ekulvalente me zgjidhjen e dy ekuacioneve

$$\sum_{1}^{n} \left(b - \frac{D_i}{\sqrt{C_i - 1}} \right) = 0 \qquad (10)$$

$$\sum_{1}^{n} \left(b - \frac{D_i}{\sqrt{C_i - 1}} \right) \left(\frac{C_i}{s^2} \quad \frac{D_i (I_o - I_i)}{(C_i - 1)^{3/2}} \right) = 0$$

Ekuacionet e mesiperm do te na japin dy kurba te tipit $s = f(h)$ per $Io - I_i$ te ndryshme, te cilat per rastin e izoseisteve te mira, duhet te priten. Pika e prerjes se tyre, do te na japë vlerat e s dhe h, pavaresisht nga njeru tjetra. Ky eshte dhe avantazhi i kesaj metode. Per kete qellim, u perpilua per makinen llogaritese, nje program sipas te cilit per termetet me harta me te mira te izoseisteve u llogariten madhesite s dhe h. Si vlere fillestare e s, gjate procesit te llogaritjes, u mor $s = 1.2$, ndersa intensiteti I_o ne epiqender ne fillim, u muar paksa me i madh se intensiteti i izoseistes se pare, zakonisht 0.05 me i madh. Pastaj ne varesi te madhesive s dhe h te gjetura u llogarit intensiteti maksimal ne baze te raportit te siperfaqeve te izoseisteve te para dhe te dyta, si izoseistet me te besueshme.

Njekohesisht u rillogariten edhe rrezet teorike temesatarizuara te izoseisteve per keto madhesi s dhe h tegjetura.

Per kete qellim u ndoq procedura e meposhteme:

Po te pranojme qe $I_o - I_i = 1$ atehere $I_o - I_2 = 2$ dhe ne baze te formules (7) do te gjejme qe:

$$\frac{D_1^2}{b2} = 10^{1/s} - 1 \quad dhe \quad \frac{D_2^2}{b^2} = 10^{2/s} - 1$$

dmth. qe:

$$\frac{S_1}{S_2} = \frac{D_1^2}{D_2^2} = \frac{10^{1/s} - 1}{10^{2/s} - 1}$$

ku S_1 dhe S_2 jane respektivisht siperfaqet e izoseistes se pare dhe te dyte.

Ndersa po te pranojme se $I_o - I_1 = 0$ dhe rrjedhimisht qe $I_o - I_2 = 1$, ne menyre tejngjashme del qe:

$$\frac{S_1}{S_2} = 0$$

Per vlera te ndermjetme te $(I_o - I_1)$ midis 0 dhe 1 do te gjejme:

$$\frac{s_1}{s_2} = \frac{10^{\left(\frac{I_o - I_1}{s}\right)} - 1}{10^{\left(\frac{1 + I_o - I_1}{s}\right)} - 1} \qquad (11)$$

Duke marre parasysh formulen e mesiperme u rillogarit intensiteti ae epiqender sipas formules:

$$I_o = I_1 + (s/2)\log\left(\frac{s_1 - s_2}{s_1 10^{1/s} - s_2}\right)^2 \qquad (12)$$

Si pas vleres se re te Io u llogariten perseri madhesite s dhe h. Vihet re se me rritjen e vleres se intensitetit ne epiqender thellesia e vatres do te vije duke u zvogeluar nemenyre te ndieshme, nderkohe qe koeficienti s ndryshoi fare pak (shih tab. 1)

Duke u bazuar ne vlerat perfundimtare te Io, s, h u llogariten rrezet teorike te ndjeshmerise sipas formules:

$$D_{i+1} = \sqrt{D_i^2 \cdot 10^{\frac{1}{s}} + b^2 (10^{\frac{1}{s}} - 1)} \qquad (13)$$

Duke krahasuar te dhenat e vrojtuara mbi rrezet e ndjeshmerise me ato teoriket , te llogaritura nga formula (13), u vu re se ndryshojne vetem rrezet e ndjeshmerive te ulta (rrezet e izoseisteve me te largeta shih tab. 1).

Kjo formule u perdor per koregjimin e hartave te izoseisteve, te disa termeteve. kur te dhenat nuk ishin te mjaftueshme.

Duhet theksuar se ne rast se korrigjimi i intensitetit ne epiqender ndjep nje vlere me te madhe se nje njesi, ne krahasim me izoseisten e pare, kjo tregon se brenda izoseistes se pare te ndertuar, duhet dhe nje izoseiste tjeter, me intensitet tjeter me te larte. Por meqenese shumica e termeteve tane jane termete teceket, siperfaqja e izoseistes me intensitet me te larte, eshte ne fakt aq e vogel sa per shkallen tone mund te mos perfillet. Ne keto raste ne u mjaftuam vetem me marrjen parasysh te vleres te intensitetit te korrigjuar per llogaritjen e thellesise.

Tabela 1

No	Termeti	Io	S	h km	Iok	Rrezet e ndjeshmerise te vrojtuara	Rrezet e ndjeshmerise te llogaritura
1.	25 nentor 1920	9.0 9.5	2.0 1.8	15 7	9.5 9.5	9-7.5; 8-18,7-34;6-75	9-7.5 , 8 -18; 7-36; 6 -69
2.	30 mars 1921	8.5 8.3	2.0 2.0	15 17	8.3 8.3	8 - 13, 7-37; 6-63; 5 -95;	8-13; 7 -32; 6 - 63; 5 -108
3.	21 nentor 1930	9.0 10.3	2.1 2.0	11 3	10.3 10.3	9-5.5; 8-11, 7 -15, 6-34,	10-(2);9-5,5.8 -11; 7-20 , 6-35;
4.	28 janar 1931	8.0 8.4	1.4 1.2	20 10	8.4 8.4	8-11,7-35; 6-71; 5 -91	8-11; 7-32; 6-76; 5-175
5.	23 shtator 1931	8.0 8.7	1.9 2.0	19 8	8.7 8.7	8-10; 7-21, 6-38;5-84	8-10; 7-20; 6-38; 5-68
6.	1 shtator 1959	8.5 8.5	1.6 1.6	18 18	8.5 8.5	8.14;7-37; 6-74;5-85	8-14;7-39; 6-84; 5-(175)
7.	26 maj 1960	8.5 9.0	1.4 1.6	12 7	9.0 9.0	(8-9)-7; (7-8) -14; 7-37, 6-68;	9-(3); 8-14; 7-31; 6-66; 5-135
8.	18 mars 1962	8.0 8.4	2.1 2.2	25 17	8.4 8.4	8-12, 7-30; 6-53; 5-104,	8-12. 7-31;6-57; 5-99
10	16 gusht 1966	7.0 7.6	2.0 2.0	13 6	7.6 7.6	7-6.5; 6-16; 5-28, 4-48;	7.6.5;6-14;5-27;4-48
11.	9 shkurt 1967	7.5 8.2	1.4 1.4	12 1	8.2 8.2	7-6.6,6-17, 5-29,4-47,3-90,	8-(2) 7-66; 6-17 ; 5-45;
12.	30 nentor 1967	9.1 9.2	2.1 2.0	14 14	9.2 9.2	9-6, 8-20,7-40; 6-80,5- (130)	9-6;8-23;7-46;6-84;5-150
13.	3 prill 1969	7.5 7.3	1.7 1.8	11 14	7.3 7.3	7-11;6-32,5-50;4-125	7-11;6-31,5-62-4-120

Per te lehtesuar procesin e llogaritjeve u perdor edhe paletka e varesise se rrezatimit se mesatarizuar D_1 prej I_0 - I_i per vlera te ndryshme te s. Kjo paletke shpreh ne fakt formulen (8) dhe jep rezultate te kenaqeshme kur rrezet e mesatarizuara jane te rregullta dhe intensiteti ne epiqender eshte korrigjuar. Rezultatet e percaktuara me paletke dhe me metoden e kateroreve me te vegjel jane gati te njellojta, prandaj ne shumicen e rasteve eshte perdorur me sukses paletka e paraqitur ne figuren 1.

Percaktimi i pavarur i madhesise s prej thellesise se vatrese sipas metodikes se mesiperme krijon mundesine e gjetjes se nje vlere te tille te s, e cila te jete sa me reale per vendin tone dhe gjetjes se ligjeshmerive tetilla midis s dhe h te cilat na lejojne te kontrollojme termetet per te cilet njohim vetem ndjeshmerine ne disa pika te vecanta. Keshtu, duke ditur madhesite M; I_0, s dhe h per termetet me izoseiste temira, u gjeten varesite:

$$I_0 = b\,M + c \qquad (14)$$

dhe:

$$I_0 + 2s \log b = b'\,M + c' \qquad (15)$$

Koeficientet h,b' dhe c,c' llogariten sipas formulave te meposhteme:

$$b,\ b' = \frac{\sigma_x}{G_x} \quad dhe \quad c,\ c' = \bar{Y} - \frac{x_.}{G_x}\,\bar{X}$$

ku:

$$\sigma_x = \sqrt{\frac{\Sigma x_i^2 - n\,\bar{X}^2}{n-1}} \quad \sigma_y = \sqrt{\frac{Y_i^2 - n\,\bar{Y}^2}{n-1}}; \quad \bar{X} = \frac{\Sigma X_i}{n} \quad \bar{Y} = \frac{\Sigma Y_i}{n} \qquad (16)$$

Madhesite X_i shprehin manjitudat M_i, kurse madhesite Y_i shprehin I_{0i} ne formulen (14) dhe madhesite ($I_0 + 2s \log h_i$) ne formulen (15).

Nga llogaritjet e kryera per gjetjen e ketyre koeficienteve rezultuan keto varesi:

$$M = 0.6\,I_0 + 1.0 \qquad (17)$$

dhe:

$$I_0 = 1.44\,M - 4 \log b + 4.5 \qquad (18)$$

Nga relacionet e mesiperme shohim se 2s =4.0, nderkohe qe ne katallogun e Ballkanit (2) ajo eshte marre baraz me 3.5 per termetet normale te vendit tone.



Fig. Nr. 1. Poletka e gjetjes se thellesise se vatres h dhe te koeficientit S

Duke u bazuar ne relacionin (18) thellesia e nje termeti per 2s=4.0 (vlere e pranuar per vendin tone) duhet te dale nga formula

$$\log b = 0.36\ M - 0.25\ I_0 + 1.125 \qquad (19)$$

Ne kete rast duhen ditur madhesite M dhe I_0.

Neqoftese dihet edhe ndjeshmeria e termetit ne disa pika, atehere thellesia e vatres sëtij sipas ndjeshmerise, llogaritet me formulen:

$$\log b = \log D_i - A \qquad (20)$$

ku madhesia $A = 1/2 \log (10^{(I_0 - I_i)/s} - 1)$. per $s = 2.0$

Kjo madhesi mund te gjendet lehte prej grafikut te paraqitur ne figuren 2 qe shpreh varesine e A prej $I_0 - I_i$ per 2s =4.0

Eshte e qarte se kur te dhenat makrosizmike dhe instrumentale jane ne harmoni me njera tjetren, vlerat e thellesive te gjetura sipas formulave (19) dhe (20) duhet te perputhen me njera tjetren. Mos perputhja e tyre do te kushtezoje ne fakt edhe gabimin ne percaktimin e thellesise se vatres se termetit, kur dihet mire epiqendra e tij. Ndersa ne ato raste kur dihet vetem ndjeshmeria dhe magnjituda, por epiqendra nuk eshte e sigurte, kjo lehasimi i ketyre formulave mund te na ndihmoje per korrigjimin e epiqendres nepermjet korrigjimit te madhesive D_i te cilat paraqesin largesine mesatare epiqender-pike vrojtimi.

b. Shkalla e intensitetit

Ne materialin e grumbulluar dhe te perpunuar nga autore te ndryshem jane perdorur shkalle te ndryshme te intensitetit. Keshtu qe autoreve te ketij studimi iu desh te unifikojne te gjitha te dhenat duke perdorur vetem nje shkalle: MSK -64 (shih shtojcen No 2). Per termetet per te cilet kemi pershkrime te efekteve siperfaqesore te tyre, eshte bere vleresimi i tyre sipas shkalles MSK -64 nga vete autoret, ndersa per te tjeret, per te cilet jepet vetem intensiteti ne epiqender, sipas shkalleve te ndryshme u perdor korelacioni midis shkalles MSK-64 dhe shkalleve te tjera, i perpiluar ky per katallogun e Ballkanit (2).

Per termetet e rinj, per te cilet nuk ka pershkrime dhe nuk njihet intensiteti, por njihet magnituda intensiteti eshte percaktuar sipas relacionit (17).

Duhet te theksojme se intensitetet e dhena nga autore te huaj, duke u bazuar ne termetet per te cilet ka pershkrime te mjaftueshme, ne pergjithesi kane qene territura ne 1-2 balle. Ndersa specialistet tane qe kane studjuar termetet e viteve 1959, 60, 1962 kane dhene vlera te ulta te intensiteteve te ketyre termeteve deri 1-2 balle.



Fig. 2

Gjate perdorimit te shkalles MSK -64 nekemi marre parasysh edhe kushtet konkrete te vendit tone. Keshtu p.sh. ne dallim me shkallen MSK-64 intensiteti prej VI ballesh karakterizohet tek ne edhe nga demtime te renda te shtepive prej guri te mbuluara me rasa guri (demtime te grades se trete) te cilat sipas kesaj shkalle duhet te konsiderohen si karakteristike per VII-ballesh. ! Perveç tipeve te ndertesave tona, gjate percaktimit ose ripercaktimit te intensiteteve, jane marre parasysh dhe konditat inxhinjero gjeologjike te qendrave te ndryshme te banimit, ku jane ndjere termetet apo ku ata jane shkaktuar demtime.

c) Hartat e izoseisteve:

Ne baze te materialit makrosizmik u ndertuan hartat e izoseisteve per 60 termetet per periudhen 1800 - 1970 me shkallen 1:500.000 (5 harta per periudhen 1800-1900; 24 harta per periudhen 1901 -1960 dhe 31 harta per periudhen 1961-70), nga te cilat vetem 37 kane kater ose me shume izoseiste; hartat e tjera kane deri tre izoseiste.

Per perpilimin e hartave u percaktua intensiteti ne pikat ku kishim pershkrime te mjaftueshme sipas shkalles MSK -64, dhe pastaj ne baze te shtrirjes gjeometrike te pikave ne plan, u be grupimi i tyre sipas intensitetit te ujejte duke neglizhuar ne pergjithesi konditat lokale, ose pikat e veçanta. Pas perpilimit te hartave uje rendesi e veçante i u kushtua korrigjimit te izoseisteve te largeta, duke u bazuar ne gjetjen e rrezeve te mesatarizuara teorike (shih formulen 13).

Gjate korregjimit te hartave te izoseisteve u morren parasysh jo vetem ligjeshmerite teorike te nxjerra dhe intensitete e vrojtuara por edhe raportet midis rrezeve te ndjeshmerise gjate dhe kryq strukturave gjeologjike. Ne pergjithesi, per shumicen e termeteve tane, ky raport eshte 2:1;

d) Percaktimi i epiqendrave:

Per percaktimin e epiqendrave te termeteve u perdoren te dhenat instrumentale dhe makrosizmike.

Sipas rregjistrimeve te stacioneve te afert dhe evropiane, te mbledhur, u perpiluan listat e hyrjeve te para te valeve gjatesore P , duke marre ne konsiderate ne radhe te pare hyrjet e para me te qarta dhe me te besueshme. Pastaj u zgjodhen ata stacione te cilet kishin uje shperndarje me te kenaqeshme kuadrejt epiqendres se supozuar ose te llogaritur me pare nga agjensite e ndryshme. Per rillogaritjen e epiqendrave instrumentale u perpilua uje program per makinen llogaritese, duke u bazuar ne procesin iterativ te Gauss-Njutonit [3] per zgjidhjen e nj ekuacioneve tetipit:

$$a_i x + b_1 y + c_1 z + d_1 \xi = R_i$$

ku:

$$a_1 = \frac{\partial ti(Di)}{\partial \lambda e} = \frac{\partial ti(Di)}{\partial Di} \cdot \frac{\partial Di}{\partial \lambda e} \quad ; \quad x = \partial \lambda e \; ;$$

$$b_1 = \frac{\partial ti(Di)}{\partial \varphi_e} = \frac{\partial ti(Di)}{\partial ri} \cdot \frac{\partial Di}{\partial \varphi e} \quad ; \quad y = \partial \varphi e \; ;$$

$$c_1 \simeq 1; \qquad z = \partial He;$$

$$d_i = \frac{\partial ti(be)}{\partial be} \; ; \qquad \xi = \partial b \; ;$$

$$R_i = t_{P_i} \cdot (H_e + t_i(r_i)) .$$

t_{P_i} jane kohet e hyrjeve te para te valeve P ne stacionin e i -te

φ_e, λe, He jane parametrat e epiqendres fillestare paraprake respektivisht: gjeresia dhe gjatesia gjeografike si dhe koha ne origjine .

Epiqendra paraprake ne fillim u muarr me nje thellesi h_e =20 km.Kohet e hyrjeve te para te valeve gjatesore: t_{P_i} u korrigjuan per elipticitetin dhe per lartesine mbi nivelin e detit sipas formulave;

$$t_{P_{ik}} = t_{P_i} + \partial t_{P_e} + \partial t_{P_d}$$

ku :

$$t_{P_e} = f(r_i)\ (b_s + H)$$

$$t_{P_d} = \frac{b_i}{5.8} \sqrt{1 - \left(\frac{5.8}{111.19} \cdot \frac{\partial ti(ri)}{\partial ri}\right)^2}$$

b_s dhe H jane lartesite e stacionit dhe epiqendres mbi sferen referuese

b_i eshte lartesia e stacionit mbi nivelin e detit

5.8 eshte shpejtesia mesatare e perhapjes se valeve gjatesore ne shtresen granitike ne km/sek

111.19 jane kilometrat koresponduese per largesine 1 grade

Per eleminimin e stacioneve me gabime te medha u perdoren ekuacionet me peshe te ndryshueshme ; peshat e çdo ekuacioni u llogariten sipas formules :

$$\omega i = \frac{1}{1 + \mu\ EXP\left(\frac{(v_i - v_{im})^2}{2\sigma^2}\right)}$$

ku: $\mu = 0.02$ $v_{im} = \frac{\Sigma V_i}{n}$; $\sigma \sqrt{\frac{\Sigma (v_i)^2}{n-4}}$

Madhesite Di gjenden sipas formules:

$$\cos D_i = a_i\ A + b_i\ B + c_i C$$

ku a_i, b_i, c_i dhe A,B,C jane respektivisht kosinuset drejtues te stacioneve dhe epiqendres paraprake

Vlerat e $\frac{\partial ti(Di)}{\partial Di}$ gjenden sipas hodografeve teorike te Globit te tabuluar.

Per kete qellim u perdoren tabelat e Jeffreys dhe Bullen.

Llogaritjet u kryen ne qendren llogaritese te ASH te RPSH.Pervete aftesite e makines, numuri i stacioneve te perdorur nuk i kalonte te 50-tet per çdo termet.

Procesi i llogaritjeve ndalej kur arrinim nje perseritje te kohes ne origjine me gabim ±1 sek. Kur epiqendra e gjetur na jepte nje gabim mesatar kuadratik te rangut te pare dhe numri i stacioneve te perdorur ishte me i madhe se 30 ajo konsiderohej si epiqender e klasit te pare me gabim ±0°1.

Duhet theksuar se zgjedhja e epiqendres fillestare brenda territorit tone nuk lot asnje rol ne rezultatin e gjetur. Neqoftese te dhenat jane te sakta dhe shperndarja e stacioneve e rregullt edhe per nje numer te vogel stacionesh, konvergjenca arrihet zakonisht pas tre iteracionesh; Edhe sikur ndryshimi i kohes fillestare te pranuar te jete rreth 1000 sek, perseri konvergjenca arrihet pas tre iteracionesh. Keshtu qe si kohe paraprake per llogaritjen e epiqendrave u muarr zakonisht koha e stacionit me te afert minus 100 sekonda, ndersa si epiqender paraprake u muarr mezi i veendit tone (41.0N 20.0E).

Ne ato raste kur kemi harta izoseistesh, si epiqender ne pergjithesi u muarr qendra e gravitetit te izoseistes se pare.

Kur dihet vetem nje pike me intensitet maksimal dhe ndjeshmeria n disa pika dhe kur te dhenat instrumental nuk na japin saktesi te kenaqeshme, u pra si epiqender pika me intensitet maksimal.

Ne rastet kur nuk njihet intensiteti maksimal, por ndjeshmeria ne disa pika te vecanta dhe te dhenat instrumentale nuk jane te besueshme, si epiqen u pranua ajo pike, qe kenaq me mire relacionet e gjetura ndermjet M, Io, h dhe s.

Per pasgoditjet, per te cilat nuk kemi percaktime te sakta instrumentale, u pranua si epiqender, epiqendra e goditjes kryesore.

Nga llogaritjet e kryera u gjet edhe koha ne origjine. Ne shumicen e rasteve u pranua koha ne origjine e dhene ne buletinet e ISS, ISC dhe BCIS.

e) Percaktimi i Magnitudes

Per percaktimin e magnitudes u perdor metodika e ndjekur nga V. Karnik per periudhen 1900-1955 (5 ,6). Ndersa per periudhen 1966-1970 u pranua magnitudat e llogaritura sipas ISC per diapazonin 4.0-5.0. Per kete diapazon vihet re qe m_B e gjetura sipas ISC jane gati te njelloita me M_{LH}. Per magnituda me te medhe se 5.0, u gjet vlera mesatare e M_{LH} te gjetura sipas formules:

$$M_{LH} = 1.66 \log D_i + 3.3 + \log (A / T) \qquad (21)$$

Gjate percaktimit te magnitudave u perdoren te dhenat e stacioneve te afert dhe te larget duke marre parasysh edhe veçorite e karakteristikave te aparatures dhe sidomos ato te sizmografeve mekanike. Per T me te vogla se 3 sekonda u llogariten magnitudat M_{LgH} sipas metodikes se propozuar nga V. Karnik.

Ne shumicen e rasteve, numuri i stacioneve sipas te cilave jane percaktuar magnitudat, eshte me i madh te V. Karnik, prandaj ne keto raste jane pranuar magnitudat e gjetura prej tij, pasi ato ndryshojne fare pak ne krahasim me ato te percaktuara prej nesh. Ky ndryshim eshte jo me shume se $\pm$ 0.1 -0.2.

Ne rastet tjera jane paraqitur magnitudat e llogaritura prej nesh. Gjate percaktimit te magnitudave, u perdoren te dhenat e stacioneve te paraqitur ne tabelen No 2.

Siç shihet nga kjo tabele, prej stacioneve italiane, jane marre parasysh vetem ato stacione, te cilet kane pasur aparate mekanike, me karakteristika te qendrueshme per nje periudhe te gjate kohe, duke perfshire ketu edhe sizmografet Vicentini, Omori dhe Cancani.

Nder gjithe stacionet italian me te besueshme dhe brenda gabimeve te treguara mesiper jane vlerat e magnitudave te llogaritura sipas te dhenave te Pompeit.

Tabela No 2

Stacioni	Periudha e observimit qe eshte marre parasysh gjate llogaritjes se magnitudave
Athina	1917 -1927 1953 -1970;
Beograd	1924 - 1970;
Strasbourg	1919 -1962;
Paris	1919 -1962;
Pola	1905 - 1916 ;
Budapest	1905 -1919; 1926 -1948;
Lubjana	1926 -1939;
Mostar	1926 -1932;
Sarajevo	1925 -1931;
Prahonice	1958 -1964;
Praha	1953 -1964;
Pompei OA I = 80 (Omori)	1911 -1928;
Padova A I = 104 - 106 (Vicentini)	1905 -1932;
Padova B I=131-132 Viceatini Iv= 1 61 -163	1905 -1932;
Casamiciola	1905 -1932; nuk eshte marre parasysh
Catania GS	1919 -1932 ; nuk eshte marre parasysh
Venezia MV I = 120 Iv = 140 - 160	1903 -1932 ;

Ne ato raste kur mungojne te dhenat instrumentale, per amplitudat dhe periudhat e valeve sizmike, per percaktimin e magnitudes eshte perdorur zgjateshmeria e rregjistrimit (2). Magnitudat e percaktuara sipas kesaj metode jane paraqitur ne kllapa ne shtojcen No 1.

&. 3. Parametrat e termeteve dhe saktesia e tyre

Duke u bazuar ne metodiken e treguar ne paragrafin e meparshem u vleresuan parametrat e termeteve te periudhes 1900-1970 duke treguar gabimin perkates per secilin prej tyre.

Koha ne origjine :

Ne shumicen e rasteve eshte pranuar koha ne origjine e raportuar nga ISS ose BC dhe sipas ripercaktimeve te kryera uga ne. Per periudhen pas vitit 1964, eshte pranuar koha ne origjine e raportuar nga ISC.

Vleresimi i gabimeve u be si me poshte:

±5 sekonda: Kur epiqendrat instrumentale dhe makrosizmike perputhen me njera tjetren me gabim ±0°1 ose kur epiqendrat instrumentale te ripercaktuara japin nje gabim mesatar kuadratik tevogel.

±15 sekonda: Kur termeti eshte rregjistruar nga disa stacione me kualitet te mire

±1 minuta: kur termeti eshte rregjistruar nga nje ose disa stacione me kualitetet te keq.

±4 minuta: Kur nuk ka te dhena instrumentale por raportimet makrosizmike perputhen me njera tjetren

± 15 minuta: Kur nuk ka te dhena instrumeatale dhe raportime makrosizmike te veçanta.

H Kur raportimet makrosizmike nuk jane te sigurta dhe gabimi mund te jete 1 ore deri 1 dite.

Epiqendrat:

Vleresimi i gabimeve u be si me poshte:

± 0°1: Kur kemi harta izosejstesh dhe epiqendra eshte percaktuar si qendra e gravitetit te izoseistes separe; ne kete rast gabimi i muadshem i percaktimit te saj nuk duhet te jete me i madh se rrezja e mesatarizuar e kesaj izoseiste. Po keto jane futur edhe ato epiqendra instrumentale, per te cilat gabimi mesatar kuadratik ka qene i vogel dhe shperndarja e stacioneve e mire.

±0°2 : Kur njihet intensiteti maksimal dhe sipas te dhenave te mjaftueshme mund te percaktohet lokaliteti ku ka ndodhur termeti

±0°3: per te gjitha rastet kur dihet te pakten rrethi ose krahina ku ka ndodhur termeti.

± 1°: per epiqendrat e pasakta per te cilat nuk kemi asnje informacion makrosizmik.

Thellesia e vatres·

Vleresimi i thellesise se vatres eshte bere duke u nisur kryesisht nga te dhenat makrosizmike. Per kete qellim u perdor krahasimi i korelacionit (19) me formulen makrosizmike (20).

Ky krahasim ka vlere vetem per ato raste kur kemi te njohur ndjeshmerine e termetit ne nje ose disa pika dhe parametrat I0 dhe M. Kur kemi harta izoseistesh ky gabim eshte shume i vogel dhe nuk i kalon ±10% te vleres se gjetur. Per rastet e tjera perhir te gabimeve te mundeshme ne vleren e magnitudes, intensitetit maksimal ose rrezes se ndjeshmerise, ky gabim eshte me i madh. Per çdo rast gabimi u llogarit vecanerisht.

Kur nuk njohim ndjeshmerine e termetit ne asnje pike, por dime magnituden e tij ose intensitetin pse te dy se bashku, thellesia eshte gjetur sipas formules (19)·

Ne kete rast nuk ka qene e mundur te behet ndonje vleresim : gabimi mund te arrij deri 100% te vleres se paraqitur ne katallog.

Magnituda:

Vleresimi i magnitudes u be duke u nisur nga numuri i stacioneve sipas te cileve ajo eshte percaktuar ose sipas zgjateshmerise se rregjistrimit (2.6).

±0.2 Ky gabim vlen per ato magnituda te cilat jane percaktuar sipas te dhenave te me shume se 10 stacioneve.

±0.3 Kur magnitudat jane percaktuar sipas te dhenave te 5 -10 stacioneve

±0.5 Kur magnitudat jane percaktuar sipas te dhenave te 2-4 stacioneve

±1 Kur magnitudat jane percaktuar sipas te dhenave te nje stacioni te vetem ose sipas zgjateshmerise se rregjistrimit

Per te gjitha rastet kur magnitudat jane gjetur me korelacion sipas formules (19) nuk eshte berendonje vleresim i saktesise se percaktimit te tyre, pasi vlerat e tyre mund te ndryshojne ne nje diapazon te gjere.

Intensiteti: I^0

Intensitetet me epiqender u vleresuan si me poshte:

Per te gjithe termetet per te cilet jane ndertuar hartat e izoseistev si gabim i percaktimit te intensitetit I_o u pranua diferenca $I_{ok} - I_1$, ku I_{ok} esht intensiteti maksimal i llogaritur sipas formules (17) dhe I_1 eshte intensiteti i izoseistes se pare duke filluar nga epiqendra.

Kur njihet intensiteti ne shume pika dhe mund te ndertohen izose te te veçanta, gabimi i percaktimit te I_o u muar $\pm$ 0.5.

Kur intensiteti njihet vetem ne disa pika te veçanta, intensitetet Io u pranua me gabim $\pm 1^0$.

Per te gjitha rastet e tjera kur epiqendrat kane qene ne det ose kur intensiteti eshte gjetur me korelacion sipas formules (17) nuk eshte bere ndonje vleresim i saktesise se percaktimit te tij.

& /4 Permbajtja e katallogut

PJESA E I_o (periudha 1900 -1970)

Kollona 2-13 permban parametrat e treguar me siper ne & 3. me gabimet perkatese

Kollona 14 tregon vendin ku ka ndodhur termeti kur dihet me saktesi zona epicentrale

Kollona 15 permban ndjeshmerine e termetit nepermjet rrezeve tomesatariznara te ndjeshmerise, ose thjesht rrezeve te vrojtuara te ndjeshmerise dh ne disa raste duke dhene ndonje karakteristike

te shkurter per ndjeshmerine.

kollona 16 permban percaktimet e kryera nga autore te tjere te ndryshme nga percaktimet tona.

kollona 17 paraqet referencat kryesore te cilat jane marre per baze gjate perpilimit te katallogut.

PJESA E II (periudha para vitit 1900)

Kollona 2-6 permban parametrat kryesore te termeteve pa bere ndonje vleresim te gabimit te percaktimit te tyre.

kollona 7 permban ndjeshmerine e termetit duke dhene per shkrime te shkurtra.

kollona 8 permban percaktimet e kryera nga autore te tjere, te ndryshme nga percaktimet tona

kollona 9 paraqet referencat kryesore qe jane marre per baze gjate perpilimit te katallogut.

SHTOJCA No 1: Perfshin te gjitha lekundjet me M 4.0 osellos VI qe jane vrojtuar ose regjistruar gjate periudhes 1900-1970.

kollona 1-5 permban parametrat kryesor te termeteve

kollona 6 permban referencat kryesore si dhe vrejtje te ndryshme ne lidhje me ndjeshmerine ose percaktime te tjera te parametrave te kryera nga autore te tjere

PJESA E III: Permban pershkrimet e termeteve me te rendesishem si dhe hartat e izoseisteve per shumicen e tyre. Gjithesej paraqiten 61 harta izoseistesh dhe pershkrime.

SHTOJCA No 2. paraqet shkallen MSK -1964 e cila eshte perdorur prej nesh gjate rivleresimit te intensiteteve.

LITERATURA

1. A. Blake « On the estimation of facal depth from macroseismе data: B S S A 31 (1941) No 3

2. « Balkan catalogue of earthquakes» Skopje 1974

3. Engdohl E.R. « Use of a high speed computer for the preliminary determination Gunst R.H. « of earthqyuakes hypocentre» BSSA vol 56 No 2 pp 325-336 april 1966

4. Fu Cen I « On macroseismic determination of the focus of earthquakes» Seience Record New Series vol 4. Nr. 5, 1960

5. Karnik V « Standartization of the magnitude scale» Stud, Geod. « Geoph, 1, 1962
Kondorskaya N.V.. etj. «

6. Karnik V. « Seiscmicity of the European area, I,II, 1968, 1970

7. Sulstarova E « Harta sizmike e RP te Shqiperise ne shkalle 1:1250000»
Kociaj S
Aliaj Sh Tirane 1972

Nr.	Data Dita muaji viti	Koha e origjines ore min sek	Gab ±	Epiqendra N°	Epiqendra E°	Gab ±	h km	Gab h	M	Gab ±	I_o	Gab ±	Vendi	Ndjeshmeria	Vrejtje	Referenca
1	2	3	4	5		6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
1	14 qershor 1900	01	H	42.1	19.6	0.5	19	-	4.6		6	1				SKA
2	2 nentor 1904	18 28	1m	42.3	19.0	0.3	8	5	4.3	0.5	7	1		6-11;5-26;4-43 (BLK)		KV,Bg,Ł,SKA
3	4 prill 1905	10 24	15s	41.0	21.0	1	34		5.3	0.5	8	1				KV,Aj,Ł,SKA
4	4 prill	11 00	1m	41.0	21.0	α	23		4.5	1	5-6					Bg,BLK
5	1 qershor	04 42	15s	42.0	19.5	0.1	11	5	6.6	0.5	9	0.2	Shkoder	9-7;8-20;7-39;8-71; 5-128; 4-230;	Io=10.5(MF);10(SA); SA3,MD,MJ8)	ACGZ,SS,Ł,VH, SKA
6	1 qershor	14 47	15s	42.0	19.5	α	10		4.5	0.5	7	1			Io=8(MD);M=4.9(KV	AB,SKA
7	1 qershor	21 47	5s	42.2	19.8	α	31		5.9	0.5	7	1			MLH=5.5(BLK)	AB,SKA,MD
8	3 qershor	05 10	15s	42.0	19.5	0.1	9	4	6.0	1	8	0.1	Shkoder	8-3;7-14;6-28;	Io=9(MD);MLH= =5.5(BLK)	SKA,Ł,AB
9	3 qershor	23 56	1m	42.1	19.6	α	22		4.1	1	5-6					AB,KV,BLK
10	5 qershor	11 09	15m	42.1	19.6	α	22		4.8	1	6					AB,KV,BLK
11	6 qershor	02 55	4m	42.1	19.6	α	19		4.6	1	6					AB,KV,BLK
12	9 qersh or	23 36	4m	42.1	19.6	α	19		4.6	1	6	1				AB,KV,BLK
13	16 qershor	12 35	15m	42.1	19.6	α	17		5.2		7	1				AB,KV,SKA,MJ8
14	30 qershor	11 53	15m	42.1	19.6	0.2	18		4.9		6-7	1		Demime te vogla ne Shkoder; dieraktuck Rrezim muresh ne Shkoder	Io=8(MD),7(AB)	AB,KV,SKA
15	30 qersh or	23 55	H	42.1	19.6	0.2	18		4.9		6-7	1				AB,KV
16	13 korrik	13 02	1m	42.1	19.6	α	17		4.8	1	6-7					AB,KV
